

VLERËSIMI I QEVERISJES
SË MIRË SË
PUSHTETIT LEGJISLATIV
NË MAQEDONINË E VERIUT
DHE NË RAJON
PËRMES INDEKSIT TË HAPJES



SIPAS MATJES PËR VITIN 2024

© 2025 Fondacioni për Internet dhe Shoqëri - "Metamorfozis"

Shkup, 2025

Titulli i origjinalit: „Процена на доброто владеење на законодавна власт во Северна Македонија и регионот преку Индексот на отвореност“

Botues: Fondacioni për Internet dhe Shoqëri - "Metamorfozis"
Rr. "Franklin Ruzvelt" Nr. 19, Kati 2, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut

Autore: Marijana Jançeska - Ugarkoviq

Redaktore: Dançe Danillovska - Bajdevska, Drejtore e programeve

Dizajni: Fondacioni për Internet dhe Shoqëri - "Metamorfozis" (Maqedoni e Veriut)

Tirazhi: kopje elektronike

Përkthimi nga maqedonishtja në shqip: Valon Abdiu

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

342.53:005.332.5(497.7)"2024/2025"(047.31)
342.53:005.332.5(497-15)"2024/2025"(047.31)

JANÇESKA-Ugarkoviq, Marijana

Vlerësimi i qeverisjes së mirë së pushtetit legjislativ në
maqedoninë e veriut dhe në rajon përmes Indeksit të hapjes [Електронски
извор] : sipas matjes për vitin 2024 / [autore Marijana
Jançeska-Ugarkoviq ; përkthimi nga maqedonishtja në shqip Valon Abdiu].
- Shkup : Fondacioni për internet dhe shoqëri Metamorfozis, 2025

Начин на пристапување

(URL): <https://metamorphosis.org.mk/wp-content/uploads/2025/10/finalna-analiza-otvorenost-na-parlamenti-alb-1.pdf>.

- Превод на делото: Процена на доброто владеење на законодавната власт
во Северна Македонија и во регионот преку Индексот на отвореност. -
Текст во PDF формат, содржи 35 стр. - Наслов преземен од екранот. - Опис
на изворот на ден 16.10.2025. - Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-263-141-7

а) Собрание -- Отвореност -- Македонија -- 2024-2025 -- Истражувања б)
Собрание -- Отвореност -- Западен Балкан -- 2024-2025 -- Истражувања

COBISS.MK-ID 67169797

Ky dokument politikash është pjesë e projektit të financuar nga Fondi Kombëtar për Demokraci.
Përmbajtja nuk i pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit.

Hyrje.....	4
Metodologjia.....	5
Hapja e parlamenteve në rajon	6
Shkalla a hapjes së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.....	12
4.1. Transformimi digjital i Kuvendit.....	18
4.2. Agjendë parlamentare e parashikueshme dhe llogaridhënëse	20
4.3. Besimi institucional përmes transparencës strategjike	21
4.4. Përfshirja e publikut në punën e organeve parlamentare	24
4.5. Llogaridhënia financiare në praktikë	25
4.6. Zhvillimi i praktikave për qasje të lirë në informata	27
4.7. Afrimi i përfaqësuesve të popullit me qytetarët	28
4.8. Demokracia funksionale përmes kontrollit të forcuar mbi pushtetin ekzekutiv	30
4.9. Përkushtimi sistematik ndaj integritetit në organin legjislativ	31
Udhërrëfyes për qeverisje të mirë për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut	33

1. Hyrje

Koncepti i qeverisjes së hapur përfshin një spektër të gjerë politikash dhe praktikash që synojnë promovimin e qeverisjes gjithëpërfshirëse, të përgjegjshme dhe efikase. Duke promovuar transparencën, duke inkurajuar pjesëmarrjen publike dhe duke forcuar përgjegjësinë dhe integritetin institucional, qeverisja e hapur kontribuon për vendimmarrje më të mirë, ulje të korrupsionit dhe ofrim më të mirë të shërbimeve publike. Transparenca, e kuptuar si ofrim proaktiv i informatave të nevojshme për mbikëqyrje publike, është një parim qendror i kësaj qasjeje, së bashku me pjesëmarrjen, llogaridhënien dhe integritetin.

Për të vlerësuar shkallën në të cilën këto vlera janë të integruara në praktikën parlamentare në vendet e Ballkanit Perëndimor, Qendra për Tranzicion Demokratik (Mali i Zi), në bashkëpunim me Fondacionin Metamorfozis (Maqedonia e Veriut), Partnerët për Ndryshim Demokratik Serbi (Serbi) dhe Shoqatën e Qytetarëve "Zashto ne" (Pse Jo?) (Bosnje dhe Hercegovinë), zhvilluan një mjet analitik të njohur si Indeksi i Hapjes.

Bazuar në Indeksin e Hapjes, e vlerësojmë nivelin e transparencës, qasshmërisë dhe llogaridhënies së parlamenteve ndaj qytetarëve dhe shoqërisë. Rezultatet e hulumtimit tregojnë mangësitë ekzistuese dhe fushat që kërkojnë reforma, dhe duke u bazuar në to ne krijojmë rekomandime për përmirësimin e aktivitetit parlamentar. Kjo iniciativë bazohet në bindjen se ndryshimet e qëndrueshme arrihen më së miri përmes partneritetit me parlamentet në të gjithë rajonin.

Prandaj, organet legjislative inkurajohen ta demonstrojnë përkushtimin e tyre të vërtetë ndaj hapjes duke përmirësuar komunikimin publik dhe duke forcuar mbikëqyrjen e punës së pushtetit ekzekutiv. Kjo kërkon një kalim nga gjestet simbolike në praktikën thelbësore dhe të qëndrueshme të përgjegjësisë. Parlamentet transparente dhe të përgjegjshme luajnë një rol kyç në ndërtimin e shoqërive demokratike që vendet tona i kanë si synim.

Këtë hulumtim jemi duke e kryer për të nëntin vit radhazi. Në këtë dokument, i paraqesim rezultatet kryesore të hulumtimit për hapjen e parlamenteve për vitin 2024/2025. Të gjitha detajet e hulumtimit tonë janë të disponueshme publikisht dhe ne mbetemi të hapur për të gjitha propozimet, kritikën me qëllime të mira dhe diskutimet rreth hulumtimit dhe përfundimeve tona.

ACTION SEE është një rrjet organizatash të shoqërisë civile që punojnë së bashku për të promovuar dhe mundësuar transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve në Evropën Juglindore, për të rritur potencialin për aktivizëm qytetar dhe pjesëmarrje qytetare, për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut në internet, si dhe për të ndërtuar kapacitetet për të përdorur teknologjitë e reja.

Metodologjia

Indeksi i Hapjes kryhet në përputhje me një kornizë të veçantë parimesh, mirëpo duke i marrë parasysh zhvillimet kulturore dhe ato historike, në vend dhe në rajon, që ndikojnë ndaj institucioneve. Metodologjia e tij jep garanci se rezultatet e hulumtimit janë teknikisht dhe politikisht të vlefshme dhe se prej tyre mund të nxirren përfundime në lidhje me nivelin e qeverisjes së mirë të institucioneve të vendit. Indeksi i Hapjes e vlerëson punën e pushtetit ekzekutiv dhe të parlamenteve në fushën e qeverisjes së mirë duke u përqendruar në katër shtylla: (1) qasshmëria, (2) efikasiteti, (3) integriteti dhe (4) transparencë, me një fushë të përbashkët që është pranishme në të katër shtyllat – të dhënat e hapura.

Katër shtyllat e Indeksit të Hapjes e përcaktojnë dhe e vlerësojnë qeverisjen e mirë me ndihmën e parimeve të mëposhtme: **qasshmëria** - e vlerëson shkallën në të cilën e drejta për qasje në informata është e garantuar me ligj dhe në praktikë, si dhe cilësinë e mekanizmave për përfshirje dhe konsultim në proceset e krijimit të politikave; **efikasiteti** - e shqyrton përkushtimin e institucioneve për të mësuar nga proceset aktuale dhe për t'i përmirësuar ato përmes sistemeve të vendosura të monitorimit, vlerësimit dhe mësimit - duke përdorur pikat/treguesit kryesorë gjatë planifikimit strategjik dhe raportimit; **transparencë** - e vlerëson disponueshmërinë publike të informatave të organizatës, buxhetit dhe procedurave të furnizimeve publike, ndërsa **integriteti** e vlerëson praninë e mekanizmave për parandalimin e konfliktit të interesave, rregullimin e lobimit, si dhe disponueshmërinë e Kodit Etik që do ta drejtojë dhe sanksionojë sjelljen e nëpunësve shtetërorë dhe të administratës publike. Secili parim i Indeksit përbëhet nga nëndomene dhe tregues që maten sipas vlerës përkatëse në kuadër të parimeve.

Metodologjia u zhvillua në konsultim me një numër të madhe burimesh të besueshme, duke i theksuar praktikat dhe standardet më të mira ndërkombëtare për qeverisje të mirë, të tilla si anka Botërore dhe Instituti, Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, Udhëzuesi për Qeverinë e Hapur, Raporti Global i Integritetit dhe Treguesit e Qeverisjes dhe Cilësisë Institucionale, të cilat i përgatiti Banka Botërore.

Hulumtimi u krye në periudhën nga shkurti deri në qershor të vitit 2025, përmes 109 treguesve për çdo parlament. Metodatat e hulumtimit përbëhen nga (1) monitorimi i ueb-faqeve të institucioneve të synuara sipas një sërë treguesish, (2) pyetësi që u dorëzohet institucioneve për t'i konfirmuar gjetjet e marra nga monitorimi në internet, (3) kërkesa për qasje të lirë në informatat me karakter publik që dërgohet me qëllim që të vlerësohet shkalla e përmbushjes së kësaj të drejte themelore nga secili institucion, si dhe (4) rishikimi i kornizës legjislative.

Gabimi i matjes është +/- 3%. Në bazë të rezultateve të hulumtimit, ne kemi kryer një analizë të pikave dhe problemeve kyçe kritike në fushën e hapjes së institucioneve, e cila shpresojmë se do të jetë e dobishme për ta përmirësuar punën e tyre. Është e rëndësishme të theksohet se në rastin kur institucionet nuk i kanë dorëzuar pyetësorët e plotësuar, treguesit janë shënuar me 0, gjegjësisht janë shënuar si tregues që nuk janë përmbushur.

HAPJA E PARLAMENTEVE NË RAJON



Hapja e parlamenteve në rajon

Parlamentet luajnë një rol kyç në sistemet demokratike dhe pritet të jenë aktorët kryesorë që u mundësojnë qytetarëve të monitorojnë në mënyrë më efikase punën e institucioneve. Megjithatë, dinamikat politike komplekse dhe shpeshherë e paqëndrueshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor e kanë dobësuar pozicionin institucional dhe funksionin demokratik të parlamenteve, gjë që e ka penguar zhvillimin dhe zbatimin e politikave të transparencës dhe hapjes.

Të dhënat nga Indeksi i Hapjes tregojnë një dallim të vazhdueshëm në rajon kur bëhet fjalë për hapjen e parlamenteve. Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut po udhëheqin, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina (BdheH) dhe Serbia ende mbeten prapa në ofrimin e informacionit mbi punën dhe aktivitetet e parlamenteve.

Sipas gjetjeve për vitin 2024/2025, Parlamenti i Malit të Zi është në vendin e parë me përmbushje prej 83,24% të treguesve të hapjes. Megjithatë, kjo përfaqëson një rënie, gjegjësisht ky është rezultati më i dobët i Parlamentit të Malit të Zi në katër vitet e fundit të matjes përmes Indeksit të Hapjes. Për dallim nga Mali i Zi, Kuvendi i Maqedonisë së Veriut, i cili renditet i dyti me 76,04%, është i vetmi parlament në rajon që ka treguar përparim të qëndrueshëm dhe të matshëm gjatë tre cikleve të njëpasnjëshme të monitorimit (74,86% në 2023/2024; 71,56% në 2022/2023).

Në vendin e tretë është Kuvendi Parlamentar i BdheH, i cili arriti një rezultat mesatar prej 59,87% - me ç'rast Dhoma e Përfaqësuesve përmbushi 60,77, ndërsa Dhoma e Kombeve 58,98% të treguesve të hapjes. Kur bëhet fjalë për parlamentet kombëtare, Serbia renditet e fundit - Kuvendi Kombëtar përmbush 59,6% të treguesve të hapjes.

Gjetjet tona tregojnë se ka mospërputhje sistemike në praktikën e transparencës dhe nxjerrin në pah nevojën që politikat e vendeve të rajonit të formësohen në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikën e mira. Informacioni në lidhje me punën e parlamenteve duhet të jetë vazhdimisht në dispozicion të qytetarëve, mediave dhe shoqërisë civile, me përmirësim të vazhdueshëm të komunikimit dhe transparencës. Megjithatë, shumica e parlamenteve në vendet e Ballkanit Perëndimor ende nuk kanë një qasje strategjike ndaj transparencës, por veprojnë ad hoc.

Gjetjet e këtij viti tregojnë se sjellja me diskrecion e udhëheqësisë është e pranishme, madje edhe kur detyrimet për të publikuar informacion në lidhje me punën dhe aktivitetet e parlamenteve janë të përcaktuara qartë. Është e dukshme se edhe parlamentet me një nivel të lartë transparence administrative ende kanë probleme serioze në praktikë, gjë që zbulon hendekun midis hapjes formale dhe funksionimit real të institucioneve demokratike.

Për të kuptuar më mirë gjetjet, raporti ofron një përmbledhje të shkurtër të ngjarjeve kryesore politike që kanë ndikuar në funksionimin dhe rolin e parlamenteve në rajon gjatë vitit të kaluar, së bashku me një analizë të të dhënave përkatëse dhe treguesve të hapjes.

Ngecje në punën e parlamenteve dhe boshllëqe procedurale në BdheH

Gjatë vitit 2024, puna e Kuvendit Parlamentar të BdheH përsëri u karakterizua me bllokime politike. Dhoma e Kombeve praktikisht u paralizua për gati tetë muaj dhe u mbajtën vetëm dy seanca të jashtëzakonshme. Si rezultat i kësaj, megjithëse buxheti dhe disa marrëveshje u miratuan, reformat kryesore strukturore mbetën të bllokuara. Bllokada e zgjatur u mundësoi aktorëve politikë të përdorin mekanizma të tillë siç është klauzola e interesit jetik kombëtar, duke e thelluar më tej krizën institucionale dhe duke i ngadalësuar reformat e nevojshme në rrugën e vendit drejt integritimit në Bashkimin Evropian (BE).

Edhe pse Dhoma e Përfaqësuesve ishte relativisht më aktive gjatë vitit 2024, funksionimi i saj u pengua ndjeshëm nga debatet politike, shtyrjet e shpeshta të seancave dhe përdorimi i gjerë i procedurave urgjente. Edhe pse përparësi iu dha miratimit të buxheteve dhe legjislacionit përkatës për procesin e anëtarësimit në BE, këto ligje zakonisht u miratuan pa debate gjithëpërfshirëse dhe kontroll të duhur publik.

Në përgjithësi, këto ngjarje tregojnë se gjatë vitit 2024 nuk është bërë ndonjë përparim i rëndësishëm drejt ndërtimit të një procesi parlamentar më konstruktiv, më transparent dhe më të hapur në BdheH.

Dobësim i funksionit kontrollues të Parlamentit të Malit të Zi

Edhe pse Mali i Zi synon t'i përfundojë negociatat me BE-në deri në fund të vitit 2026 dhe të jetë e gatshme për anëtarësim në vitin 2028, reformat e zbatuara në praktikë sjellin rezultate të kufizuara. Kuvendi duhet të jetë një mbështetës kryesor i këtij procesi, por puna e tij tregon një numër problemesh: mungesë transparence të procesit legjislativ, përfshirje të pamjaftueshme dhe kontroll të kufizuar të pushtetit ekzekutiv.

Në vend që të mbikëqyrë pushtetin ekzekutiv dhe kështu të jetë një mbështetës i vërtetë i integritetit evropian, Parlamenti funksionon gjithnjë e më shumë si një instrument i shumicës politike, e cila, falë një numri të mjaftueshëm votash, e formëson jetën "demokratike" sipas dëshirës së vet, duke e injoruar ekuilibrin kushtetues të pushtetit. Ky problem reflektohet veçanërisht në mbajtjen e parregullt të orës së takimit të Kryeministrit dhe organizimin e rrallë të debateve kontrolluese, gjë që tregon thellësinë e problemit në ushtrimin e një funksioni kyç parlamentar.

Në fund të vitit 2024, opozita filloi të bllokojë Parlamentin për shkak të vendimit për të nxjerrë në pension një gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese, kur qeveria dhe opozita kishin interpretime të kundërta të procedurave dhe juridiksionit¹. Kriza zgjati deri në mars të vitit 2025, kur, me ndërmjetësimin e BE-së, u arrit një marrëveshje midis Kryeministrit Millojko Spajiq dhe opozitës për të kërkuar opinion nga Komisioni i Venedikut për këtë rast. Megjithatë, mendimi i Komisionit

¹ "Një bombë tymi u hodh në një komision në Parlamentin e Malit të Zi, opozita pretendon se është kryer grusht shteti kushtetues", Radio Evropa e Lirë, 17.12.2024

shkaktoi interpretime të ndryshme dhe kontradiktore, gjë që vë në dukje rrezikun që rekomandimet të mos shndërrohen në reforma konkrete.

Kthesë politike në Maqedoninë e Veriut

Në vitin 2024, Maqedonia e Veriut përjetoi një trazirë të rëndësishme politike, të karakterizuar me një riorganizim të plotë të pushtetit parlamentar. Viti filloi me formimin e një qeverie teknike të udhëhequr nga Talat Xhaferi dhe me përgatitjet për zgjedhjet paralele presidenciale dhe parlamentare të caktuara për t'u mbajtur në maj të vitit 2024. Në këto zgjedhje fitoi partia opozitare VMRO-DPMNE, duke fituar 58 nga 120 mandate me koalicionin "Maqedonia jote", duke u bërë forca më e madhe parlamentare. Paralelisht, Gordana Siljanovska-Davkova e VMRO-DPMNE-së u zgjodh presidente e vendit - duke u bërë gruaja e parë që mban atë pozitë - gjë që e konsolidoi edhe më shumë dominimin e partisë.

Parlamenti tani përballlet me detyrën e zbatimit të reformave komplekse, duke përfshirë edhe ndryshimet kushtetuese që lidhen me anëtarësimin në BE. Në qershor të vitit 2024, Parlamenti miratoi ristrukturimin e pushtetit ekzekutiv, gjegjësisht zgjerimin e numrit të ministrive nga 16 në 20, ndarjen e Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës në Ministrinë e Transformimit Digjital dhe Ministrinë e Administratës Publike, dhe krijimin e ministrive të veçanta për energjinë, sportin dhe të ngjashme.

Pas miratimit të ligjit që i mundësoi këto ndryshime, pati pakënaqësi të madhe publike. Platforma e organizatave të shoqërisë civile për luftën kundër korrupsionit, anëtare e së cilës është Fondacioni Metamorfozis, reagoi publikisht ndaj mungesës së një procesi konsultativ gjatë ndryshimit të Ligjit sistemor për Organizimin dhe Punën e Organeve të Administratës Shtetërore.

Kriza e demokracisë parlamentare në Serbi

Pas zgjedhjeve parlamentare të mbajtura më 17 dhjetor 2023, Partia Progresive Serbe (SNS), që kryeson në koalicion, e ruajti dominimin e saj, duke fituar 129 nga 250 vende. Parlamenti Evropian, ODIHR-i dhe Këshilli i Evropës shprehën shqetësime serioze në lidhje me parregullsitë dhe pengesat demokratike gjatë zgjedhjeve². Megjithatë, parlamenti i sapozgjedhur nuk zgjodhi një qeveri të re deri në ditën e fundit të afatit ligjor.

Aksidenti tragjik i 1 nëntorit 2024 në Novi Sad, kur u shemb një tendë e stacionit të trenit duke vrarë 16 persona, shkaktoi protesta masive dhe ndikoi në punën e parlamentit. Shumica parlamentare refuzoi të diskutonte për ngjarjen, ndërsa deputetët e opozitës u përpoqën të fillonin një diskutim. Hapësira qytetare dhe mediat e pavarura ishin nën presion, ndërsa kritikët paralajmëruan për një rënie të lirive demokratike. Në nëntor të vitit 2024, tensionet në parlament u përshkallëzuan në përleshje fizike, kur deputetët e opozitës akuzuan qeverinë për korrupsion

² Votuesit kishin alternativa politike në zgjedhjet e Serbisë, por ato u dëmtuan nga avantazhi dërmues i partisë në pushtet, thonë vëzhguesit ndërkombëtarë, OSBE, 18.12.2023: <https://www.osce.org/odihr/elections/serbia/560698>

dhe kërkuan hetim dhe dorëheqje³. Disa ditë më vonë, shumica e miratoi buxhetin e shtetit të vitit 2025 pa debat të mirëfilltë, të cilin deputetët e opozitës e kritikuan si një veprim antidemokratik.

Kryeministri Milosh Vuçević dha dorëheqje në janar të vitit 2025 pas një incidenti në të cilin anëtarët e SNS-së lënduan përmes dhunës një studente. Dorëheqja e tij nuk u konfirmua deri në fund të marsit 2025, sepse Kryetari i Parlamentit nuk donte të caktonte një seancë të jashtëzakonshme për ta konfirmuar dorëheqjen, megjithëse kjo është një procedurë e zakonshme në situata të tilla, por iu desh të priste që të caktohej një seancë e rregullt e Parlamentit.

Fillimi i seancës pranverore të Parlamentit u shënuar nga incidente të reja. Gjatë seancës së parë më 4 mars 2025, opozita dhe qeveria hynë përsëri në konflikt. Incidentet filluan kur shumica qeverisëse, me kundërshtimin e opozitës, miratoi agjendën që përfshinte dhjetëra propozime ligjore, pas së cilës opozita filloi të hidhte mjete piroteknike, duke akuzuar qeverinë se nuk ka legjitimitet për të miratuar ligje pas dorëheqjes së kryeministrit⁴. Salla ishte e mbushur me tym, britma dhe konflikte fizike, dhe të paktën tre deputetë u lënduan. Pavarësisht kaosit të shkaktuar, seanca vazhdoi dhe më 16 prill 2025, Parlamenti zgjodhi një qeveri të re.

Disponueshmëria e informacionit mbi aktivitetet parlamentare

Të dhënat nga Indeksi rajonal i Hapjes tregojnë se disa parlamente në rajon nuk përmbushin asnjë nga treguesit bazë që lidhen me disponueshmërinë e informacionit në lidhje me punën e tyre.

Serbia dallohet si i vetmi vend në rajon që nuk i publikon biografitë e deputetëve të saj të rinj - as të Kuvendit Kombëtar e as të Kuvendit të Krahinës Autonome të Vojvodinës. Listat e nëpunësve shtetërorë dhe punonjësve janë të disponueshme vetëm në faqet e internetit të Parlamentit të Malit të Zi, Parlamentit të Maqedonisë së Veriut dhe Dhomës së Përfaqësuesve të Parlamentit të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës.

Informacion mbi të ardhurat e deputetëve publikon vetëm Parlamenti i Malit të Zi dhe Dhoma e Popujve të Parlamentit të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës. Megjithatë, fletët e pasurisë, gjegjësisht formularët e deklarimit të pasurisë të deputetëve janë të disponueshme publikisht në të gjitha vendet, me përjashtim të Kuvendit Kombëtar të Republikës Serbe, ku informacioni mbi statusin e pasurisë së deputetëve për mandatet 2022-2026 nuk është i disponueshëm.

Dhoma e Përfaqësuesve të Parlamentit të Federatës së BdeH, të dy dhomat e Parlamentit të BdeH dhe Kuvendi Kombëtar i Republikës Serbe publikojnë plane vjetore pune, ndërsa raportet e punës janë të disponueshme vetëm në faqet e internetit të Parlamentit të Malit të Zi, Kuvendit të Maqedonisë së Veriut dhe të të dy parlamenteve në BdeH.

³ Lena Stevanović, "Rrahje në Parlament: Deputetët u përleshën fizikisht për një banderolë me duar të përgjakshme në Parlamentin serb, Danas, 25.11.2024.

⁴ "Bomba tymi dhe incidente në seancën e Parlamentit të Serbisë", Radio Evropa e Lirë, 4.3.2025.

Kur bëhet fjalë për transparencën financiare, buxhetet vjetore, por jo edhe llogaritë përfundimtare, mund të gjenden në faqet e internetit të shumicës së parlamenteve. Gjithashtu, informacioni në lidhje me raportin financiar gjysmëvjetor mund të gjendet vetëm në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut.

Parlamentet në rajon kanë një praktikë të publikimit të planit vjetor të furnizimeve publike, me përjashtim të Kuvendit Kombëtar të Serbisë. Nga ana tjetër, raporti vjetor mbi furnizimet e realizuara publike është i panjohur për gjysmën e parlamenteve në rajon. Gjithashtu, kontratat e furnizimeve publike publikohen vetëm nga Parlamenti i Malit të Zi dhe Kuvendi i Maqedonisë së Veriut.

Kuvendi i Krahinës Autonome të Vojvodinës është i vetmi parlament në rajon, seancat e të cilit nuk transmetohen publikisht, ndërsa seancat e trupave punues nuk transmetohen as në BdheH.

Vetëm Parlamenti i Malit të Zi, Kuvendi Kombëtar i Serbisë dhe Kuvendi Kombëtar i Republikës Serbe ofrojnë një kanal të drejtpërdrejtë në faqet e tyre të internetit përmes të cilit qytetarët mund të parashtojnë kundërshtime, apele ose ankesa, ndërsa mekanizma të tillë nuk janë të disponueshëm në faqet e internetit të parlamenteve të tjera të analizuara. Mali i Zi është i vetmi vend në rajon që ka zbatuar një mekanizëm për peticione elektronike, por është praktikë që parlamenti të mos i trajtojë të gjitha peticionet elektronike të iniciuara nga qytetarët në mënyrë të barabartë, kështu që ato peticione elektronike, temat e të cilave i përshtaten shumicës në pushtet, vendosen menjëherë në rend të ditës, ndërsa të tjerat duhet të kalojnë nëpër një procedurë të ngadaltë.

Rezultatet e Indeksit të Hapjes tregojnë se shumica e parlamenteve nuk janë të përkushtuara për të publikuar informacione dhe dokumente në format të hapur.

Dobësitë në procesin legjislativ në rajon

Analiza krahasuese e praktikave legjislative në BdheH, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut dhe Serbi tregon një trend shqetësues: Edhe pse deputetët kanë të drejtën kushtetuese për të iniciuar ligje, ky autorizim në rajon ose përdoret minimalisht ose keqpërdoret strategjikisht për qëllime politike.

Serbia veçohet si një shembull ekstrem, ku deputetët zyrtarisht kanë propozuar vetëm tre ligje⁵ në vitin 2024, gjë që tregon se parlamenti është nën kontroll të fortë të pushtetit ekzekutiv dhe potencialisht është reduktuar në rolin e një "ngrohësi uji që ngroh sipas nevojës". Në të kundërt nga kjo, Mali i Zi shënon një numër të konsiderueshëm ligjesh të iniciuara nga deputetët, por mungesa e debatit publik ose i hartimit të vlerësimeve të ndikimit në këto raste ndikon negativisht në transparencën dhe përfshirjen e procesit legjislativ. Maqedonia e Veriut tregon një model të ngjashëm, me më pak se gjysmën e ligjeve të miratuara të iniciuara nga deputetët, ndërsa mbi 80% e të gjitha ligjeve u miratuan përmes procedurave të shkurtuara dhe pa bërë

⁵ Të tre rastet kanë të bëjnë me ndryshime dhe plotësimeve të ligjeve ekzistuese.

vlerësim të ndikimit të tyre. Bëhet një shembull i ndryshëm, ku ndikimi i aktivitetit nuk është i papërfillshëm, por i gjithë procesi legjislativ mbetet thellësisht i penguar nga bllokat politike, përdorimi i shpeshtë i procedurave të përshpejtuara dhe konsultimet simbolike.

Këto gjetje tregojnë se ka dobësi strukturore në procesin legjislativ dhe se rregullat procedurale ose injorohen ose keqpërdoren në varësi të interesit politik. Krahësimi i rezultateve të hulumtimit në nivel rajonal, por edhe gjatë një periudhe prej gati një dekade, tregon se është e nevojshme të rishikohet dhe të reformohet roli i deputetëve, si dhe vetë institucioni në nivelin e të gjithë rajonit. Është e nevojshme të standardizohen kompetencat legjislative dhe mbikëqyrëse të parlamenteve përmes procedurave dhe forcimit të masave mbrojtëse për të siguruar që ligjet - pavarësisht se kush i iniciu ato - të përhaten në konsultim me publikun e interesuar dhe t'i pasqyrojnë nevojat e vendeve në rajon.


SHKALLA A HAPJES SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



Shkalla a hapjes së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Në kuadër të matjes së këtij viti sipas Indeksit të Hapjes, Parlamenti i Maqedonisë së Veriut renditet i dyti në rajon, me një përmbushje totale prej 76,4% të treguesve të hapjes. Për më tepër, progresi është i vazhdueshëm - nga 71,56% në vitin 2022/2023, 74,86% në 2023/2024, në 76,04% aktuale në vitin 2024/2025.


Edhe pse, ashtu si edhe vitin e kaluar, parlamenti malazez vazhdon të pozicionohet si më i hapuri në rajon, Kuvendi i Maqedonisë së Veriut shënon përparimin më të rëndësishëm prej 4,48% krahasuar me rezultatet e dy viteve më parë. Nga njëra anë, ky rezultat është për shkak të angazhimit të vazhdueshëm të Kuvendit të Maqedonisë për rritjen e transparencës dhe disponueshmërinë për publikun, dhe nga ana tjetër, për shkak të ngecjes ose përkeqësimit të lehtë të hapjes midis parlamenteve të tjera në rajon.



Infografiku 1. Progresi në hapjen e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë sipas Indeksit të Hapjes në tre vitet e fundit

Në nivel kombëtar, Kuvendi i Maqedonisë renditet i gjashti për nga hapja, menjëherë pas Ministrisë së Mbrojtjes (83%), Inspektoratit Shtetëror Administrativ (78,48%), Byrosë së Furnizimeve Publike (77,81%), Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (77,32%) dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (76,29%). Vitin e kaluar, Kuvendi ishte në vendin e pestë për sa i përket hapjes, por këtë vit, organet në përbërje të qeverisë shënojnë një përparim të dukshëm.

6 institucionet më të hapura në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sipas matjes së Indeksit të Hapjes të kryer në vitin 2025




Infografiku 2. 6 institucionet më të hapura në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sipas matjes së Indeksit të Hapjes të kryer në vitin 2025

Edhe pse Kuvendi nuk është më pjesë e pesë vendeve të para, progresi i arritur është mjaft i dukshëm. Kuvendi arrin të ruajë një nivel të qëndrueshëm transparence pavarësisht mungesës së dukshme të konsensusit ndërpartiak dhe polarizimit të thelluar politik.

Sipas përgjigjeve në pyetësor nga Parlamenti, në vitin 2024 u miratuan gjithsej 184 ligje. Nga numri i përgjithshëm i ligjeve të miratuara, 148 ligje (80,43%) u miratuan me procedurë të shkurtuar. Edhe pse arsyet e vërteta për zbatimin e kësaj procedure mund të shpjegohen vetëm nga propozuesit, në praktikë përdoret më shpesh neni 170 i Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Sipas këtij neni, propozuesi mund të propozojë debat sipas procedurës së shkurtuar në rastet kur bëhet fjalë për ligj kompleks dhe të madh, kur rregullohet ndërprerja e vlefshmërisë së një ligji ose e dispozitave të tij individuale, ose kur çështjet që rregullohen nuk janë të një natyre komplekse. Edhe pse kjo mundësi mundëson miratimin më të shpejtë të ligjeve të caktuara, përdorimi i shpeshtë i procedurës së shkurtuar ngre pyetje në lidhje me cilësinë e procesit legjislativ, veçanërisht në aspektin e transparencës, debatit publik dhe përfshirjes së palëve të interesuara.

Përqindja e ligjeve të miratuara me procedurë të shkurtuar
nga viti 2016 deri në vitin 2024



Infografiku 3. Përqindja e ligjeve të miratuara me procedurë të shkurtuar nga viti 2016 deri në vitin 2024

Në vitet 2023 dhe 2024, ka një rritje rekorde të numrit të ligjeve të miratuara me procedurë të shkurtuar. Në vitin 2023, nga 90 ligje të miratuara, 70 u miratuan me procedurë të shkurtuar (77,77%), ndërsa në vitin 2024, kjo përqindje u rrit në 80,43%.

Kjo është theksuar edhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2024 për Republikën e Maqedonisë së Veriut, i shqyrtuar në Parlament në Seancën e 22-të⁶. Raporti vë në dukje rritjen në përdorimin e procedurave të shkurtuara në miratimin e ligjeve, duke përfshirë edhe propozim-ligjet e propozuara nga deputetët e përbërjes së 10-të parlamentare. “Opozita e kritikoi Qeverinë dhe votoi kundër përdorimit joadekuat të procedurës së përshpejtuar me “flamur evropian” për propozimet që nuk lidhen me harmonizimin e legjislacionit me legjislacionin e BE-së” - thuhet në raport, ku poashtu potencohet se përdorimi i procedurës së “flamurit evropian” nuk është konsekuent dhe se në një numër të madh rastesh, ajo nuk ka të bëjë me ligjet që synojnë kryesisht harmonizimin e legjislacionit kombëtar me legjislacionin e BE-së. Raporti vë në dukje se as Kuvendi e as Qeveria nuk kanë përcaktuar procedura për vlerësimin sistematik *ex-post* të ligjeve dhe politikave.⁷

⁶ Rendi i ditës i Seancës së 22-të të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjetet në: <https://www.sobranie.mk/detali-na-sednica.nsp?sessionId=1b2ecaf0-3c25-45e2-a772-176e0bf42b80>


⁷ Raporti i Komisionit për Maqedoninë e Veriut për vitin 2024. Gjetet në: <https://www.sobranie.mk/preview?id=78a5ae1b-6661-4221-86af-c6d576cf1c14&url=https://sp.sobranie.mk/sites/2023/materials/638670177089828276/Documents/638675298186259363.docx&method=GetDocumentContent>

Mbetet i vlefshëm rekomandimi që kemi bërë për të tetin vit radhazi, se **Kuvendi duhet t'i kushtojë vëmendje kufizimit të praktikës së miratimit të ligjeve përmes procedurës së shkurtuar vetëm në rastet e parashikuara në përputhje me Rregulloren e Punës, që përndryshe do të thotë se kjo mundësi po keqpërdoret me qëllim të kufizimit të konsultimeve dhe debatit mbi ato propozim-ligje⁸.**

Pavarësisht nga lloji i procedurës legislative, të gjitha vlerësimet e ndikimit rregullator duhet t'i dorëzohen Parlamentit së bashku me aktet e propozuara legislative. Për më tepër, është e nevojshme që Kuvendi të krijojë një praktikë të vlerësimit strategjik të ndikimeve të mundshme të akteve ekzistuese dhe atyre të propozuara, veçanërisht kur iniciativa buron nga vetë deputetët. Në këtë drejtim, ata kanë në dispozicion edhe organet mbështetëse, të tilla si Instituti Parlamentar, i cili ofron analiza dhe hulumtime, si dhe Zyrën e Buxhetit Parlamentar, në mënyrë që t'u mundësojnë atyre të përgatisin propozime legislative me cilësi më të mirë dhe të bazuara në informacion. Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për vitin 2024 për Republikën e Maqedonisë së Veriut thotë se nevojiten përpjekje të mëtejshme për të sqaruar përgjegjësitë në institucionet e hartimit të politikave, si dhe duhet siguruar funksionimin e tyre të duhur dhe për të racionalizuar raportimin. Komisioni Evropian, në raportin e tij vë në dukje se zhvillimi i politikave dhe legjislacionit të bazuar në prova sigurohet vetëm pjesërisht, dhe se cilësia dhe hartimi i vlerësimeve të ndikimit rregullator dhe konsultimet publike janë shumë të kufizuara.

Në vitin 2024, Qeveria propozoi 136 ligje, ndërsa deputetët propozuan 48 ligje (35,29%). Kjo është një rënie në propozimet e paraqitura nga deputetët krahasuar me vitin e kaluar, por është një rritje krahasuar me situatën dy vjet më parë. Në vitin 2023, deputetët propozuan 27 ligje (42%), krahasuar me 63 ligje të propozuara nga Qeveria. Në vitin 2022, ndryshimi është edhe më i madh – 88 ligje u propozuan nga Qeveria, ndërsa 11 ligje (12,5%) u propozuan nga deputetët.

⁸ Rregullorja e Punës së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë (tekst i konsoliduar). Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjetet në: <https://tinyurl.com/txbmpschr>



Infografiku 4. Numri i ligjeve të propozuara nga Qeveria dhe deputetët

Në Maqedoninë e Veriut, kuotat gjinore u prezantuan për herë të parë në vitin 2002. Atëherë u përcaktua që të paktën 30% e kandidatëve në listat zgjedhore, si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë lokal, duhet të jenë të gjinisë më pak të përfaqësuar. Kjo dispozitë u përmirësua në vitin 2006,⁹ me kushtin që çdo vend i tretë në lista të rezervohet për kandidat të gjinisë më pak të përfaqësuar. Në vitin 2015, u bënë ndryshime në Kodin Zgjedhor¹⁰ me të cilat u fut detyrimi për partitë politike që të sigurojnë përfaqësim prej të paktën 40% për gjininë më pak të përfaqësuar në listat zgjedhore për deputetë, si dhe për anëtarët e këshillave komunale dhe Këshillit të Qytetit të Shkupit, gjegjësisht për çdo tre vende, të paktën një vend i takon gjinisë më pak të përfaqësuar dhe përveç kësaj të paktën edhe një vend për çdo dhjetë vende (neni 64, paragrafi 5).

Pas zgjedhjeve të mbajtura në maj të vitit 2024, u konstituua përbërja e re parlamentare me gjithsej 120 deputetë. Prej tyre, 47 (39,2%) janë gra, ndërsa 73 janë burra¹¹. Mandati i mëparshëm nga viti 2020 deri në vitin 2024 kishte 43 gra (35,8%) deputete, ndërsa pas formimit të Qeverisë në vitin 2020, numri i grave deputete u rrit në 46 (38,3%)¹². Përbërja parlamentare 2016-2020 solli 38 deputete femra, ose 31,7%. Kështu, duke parë prapa, vërehet një trend pozitiv kur bëhet fjalë për përfshirjen dhe përfaqësimin e barabartë gjinor në parlamentin e Maqedonisë.


⁹ Kodi Zgjedhor i vitit 2006. Gjendet në: <https://fiskalntransparentnost.org.mk/index.php/izboren-zakonik-gra%D1%93ansko-uchestvo-zakonodavna-vlast?utm>

¹⁰ Kodi Zgjedhor i vitit 2015. Gjendet në: https://drive.google.com/file/d/1yOTG7wVUyNoUk1_AkIYrNbD4gHQWzS5y/view

¹¹ Gjendet në: <https://data.ipu.org/parliament/MK/MK-LC01/data-on-women/?utm>

¹² Gjendet në: <https://www.parliament.nz/mi/pb/parliamentary-relations/ipr-news-and-events/ipu-release-2020-women-in-parliament-report-iwd2021/?utm>

Përfaqësimi i deputetëve dhe deputeteve në tre përbërjet e fundit parlamentare



Infografiku 5: Përfaqësimi i deputetëve dhe deputeteve në tre përbërjet e fundit parlamentare

Klubi i Deputeteve është një grup joformal në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, i përbërë nga të gjitha deputetet, pavarësisht nga përkatësia e tyre partiake. I krijuar më 7 mars 2003, në kuadër të projektit rajonal të Paktit të Stabilitetit - Tavolina e Barazisë Gjinore, me mbështetjen e partnerëve lokalë: Lobi i Grave Maqedonase, Lidhja - Këshilli Kombëtar për Barazi Gjinore (SOZHM) dhe Njësia për Avancimin e Barazisë midis Gjinive në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale. Qëllimi i Klubit është i përbashkët dhe i qartë - të arrihet barazia gjinore përmes zgjidhjeve ligjore, të avancohen të drejtat e grave, të mundësohet pjesëmarrja e tyre aktive në proceset e vendimmarrjes dhe të kontribuohet në forcimin dhe zgjerimin e demokracisë në të gjitha sferat e shoqërisë.

Në Maqedoninë e Veriut, nuk ka kuotë kur bëhet fjalë për zgjedhjen e të rinjve si deputetë. Në përbërjen aktuale politike, vetëm tre deputetë janë nën 30 vjeç në kohën e pranimit të detyrës parlamentare. Prej tyre, njëra është grua, ndërsa dy të janë burra¹³. Në përbërjen e mëparshme parlamentare, numri i deputetëve më të rinj se 30 vjeç në momentin e pranimit të detyrës parlamentare ishte katër.¹⁴

¹³ Gjendet në: <https://data.ipu.org/parliament/MK/MK-LC01/data-on-youth/>

¹⁴ MUNGESA POLITIKE E TË RINJVE: Analizë e pozicionit të të rinjve në zgjedhjet parlamentare të vitit 2020. Fondacioni për Demokraci - Westminster. Gjendet në: <https://www.wfd.org/sites/default/files/2022-02/Youth%20Political%20Absence%20-%20MK%20-%20web.pdf>

4.1. Transformimi digjital i Kuvendit

Ueb-faqja e modernizuar e Parlamentit ofron qasje më të lehtë në informacionin e publikuar nga Parlamenti, në mënyrë që çdo qytetar të mund të marrë pjesë në mënyrë të informuar në vendimmarrje gjatë zgjedhjeve dhe referendumeve. Faqja e re është përshtatur për kategori të caktuara të personave me aftësi të kufizuara, me mundësinë e zmadhimit të shkronjave dhe kalimit në modalitetin bardhë e zi. Janë gjithashtu të disponueshme edhe disa skedarë audio të dedikuar për personat me shikim të dëmtuar¹⁵, ndërsa materialet në alfabetin e Brejit për personat me shikim të dëmtuar mund të gjenden në ambientet e Institutit Parlamentar.

Me mbështetje financiare nga Instituti Demokratik Kombëtar dhe sipas Planit të Punës së Institutit Parlamentar për vitin 2024, deputetët dhe punonjësit e Shërbimit të Kuvendit, vazhduan të mësojnë gjuhën maqedonase të shenjave. U përfshinë 34 persona, nga të cilët 23 pjesëmarrës në nivelin bazë dhe 11 pjesëmarrës në nivelin e avancuar¹⁶.

Sipas raportit "Pasqyrë Krahësuese" të Institutit Parlamentar¹⁷ nga qershori i vitit 2024, faqet e internetit dhe aplikacionet mobile të sektorit publik, duke përfshirë edhe ato të Parlamentit, duhet të jenë harmonizohen me Direktivën Evropiane (BE) 2016/2102 dhe standardin teknik WCAG 2.0 (niveli AA). Ky dokument vë në dukje se Kuvendi ka pranuar detyrimin për e-qasshmërinë dhe është në proces të transpozimit të udhëzimeve nga direktiva në rregulloren kombëtare. Megjithatë, raportet e detajuara teknik për harmonizim plotë me WCAG-në¹⁸ nuk janë publikuar, gjë që tregon se, megjithëse ka hapa pozitivë, të dhënat transparente mbi përbushjen e të gjitha kriterëve ende janë në fazën e zhvillimit. Ky harmonizim ishte pjesë e rekomandimeve tona vitin e kaluar.

Vitin e kaluar, Kuvendi nuk kishte publikuar Politikë të Privatësisë, as Politikë për Kukit, gjë që çoi në rekomandimin tonë për përmirësim në këtë fushë. Këtë vit, përparimi drejt mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë së përdoruesve është i dukshëm, pasi faqja e internetit e Parlamentit përmban si Politikën e Privatësisë ashtu edhe Politikën e Kukive, si dhe një Deklaratë Privatësie gjatë kryerjes së mbikëqyrjes me video¹⁹. Politika e Kukive shpjegon në mënyrë transparente se çfarë lloje kuki-sh përdor faqja e internetit, si dhe cili është qëllimi i secilit prej tyre. Politika e Privatësisë ofron informacion mbi mënyrën se si Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut i përpunon të dhënat personale të vizitorëve të faqes së internetit, mënyrën e përdorimit dhe mbrojtjes së tyre, si dhe të drejtat në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale. Deklarata për Privatësinë, nga ana tjetër, e shpjegon llojin e të dhënave personale që Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut i mbledh nga qytetarët kur vizitojnë ambientet zyrtare dhe si përdoren këto të dhëna.

¹⁵ Gjendet në: <https://www.sobranie.mk/aktivnosti-na-parlamentarniot-institut.nspk>

¹⁶ Gjendet në: <https://www.sobranie.mk/content/%D0%9F%D0%98%202024/Plgodishenizveshtaj2024.pdf>

¹⁷ Gjendet në: https://www.sobranie.mk/aktivnosti-na-parlamentarniot-institut-nk_article-istrazuvacki-raboti-po-sopstvena-inicijativa-na-parlamentarniot-institut-2024-godina.nspk

¹⁸ Përmbledhje e bazave të qasshmërisë. Iniciativa për Qasshmërinë në Ueb (Web Accessibility Initiative - WAI). Gjendet në: <https://www.w3.org/WAI/fundamentals/>

¹⁹ Gjendet në: <https://www.sobranie.mk/politika-za-privatnost.nspk?utm>

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut është i vetmi në rajon që ka Portalin e vet të të Dhënave të Hapura, i cili pritet të rrisë ndjeshëm transparencën dhe llogaridhënien e institucionit. Përmes këtij Portali, përdoruesit kanë qasje në të dhëna në formën e tyre bazë, të lexueshme nga makina, gjë që mundëson përdorimin e tyre të mëtejshëm për hulumtime, analiza, storje mediatike dhe zhvillimin e zgjidhjeve digjitale për sfidat aktuale shoqërore.


Ndërsa po përgatitnim hulumtimin e vitit të kaluar, portali ende nuk ishte gati për përdorim. Këtë vit, situata është ndryshe. Portali i të dhënave të hapura është plotësisht funksional. Të dhënat e hapura janë ndarë në kategori: Financat, Rezultatet e Zgjedhjeve, Instituti Parlamentar, Përbërja parlamentare, Seancat dhe Shërbimi Parlamentar. Përmes Portalit mund të dorëzohet edhe Kërkesë për të Dhëna të Hapura - një shërbim që është kërkuar tashmë nga tre ekipe pjesëmarrësish në hakatonin "Ura Digjitale".

Hakatonit treditor i mbajtur në fund të tetorit të vitit 2024 synonte të lidhte programuesit e rinj me Parlamentin duke zhvilluar zgjidhje inovative softuerike duke përdorur grupe të dhënash nga portali i të dhënave të hapura të Parlamentit, Portali Kombëtar i të Dhënave të Hapura dhe Portali i Financave të Hapura. Ngjarja është dizajnuar për të frymëzuar dhe inkurajuar talentët e rinj që të shfrytëzojnë fuqinë e të dhënave të hapura dhe të zhvillojnë zgjidhje softuerike që do të përdoret për të mirën publike dhe që do të adresojë sfida të ndryshme shoqërore. Hakatonit u zbatua si pjesë e Programit të Mbështetjes Parlamentare, ndërsa Parlamenti i Maqedonisë ishte nikoqir²⁰.

Edhe pse pjesëmarrja e përfaqësuesve të Kuvendit në ngritjen e kapaciteteve të brendshme për të dhënat e hapura është e mirëpritur, Kuvendi përmbush vetëm 49,18% të treguesve që lidhen me këtë fushë, gjë që tregon se ka një përparim modest krahasuar me matjen e vitit të kaluar (46,59%). Është e nevojshme të theksohet se Kuvendi ka arritur një rritje të vazhdueshme gjatë viteve, gjë që është për t'u përshëndetur.

²⁰ Gjendet në: <https://data.sobranie.mk/mk/vesti/sobraniski-khakaton/>

Krahasimi i përmbushjes së treguesve të të dhënave të hapura



Infografiku 6. Përqindja e përmbushjes së treguesve të të dhënave të hapura sipas Indeksit të Hapjes

Ajo që Kuvendi e shënon si përparim në sigurimin e një mjedisi demokratik online është krijimi dhe publikimi i Regjistrimit të Organizatave²¹ - një mjet që synon digjitalizimin e punës së shërbimeve parlamentare në fushën e bashkëpunimit me organizatat e regjistruara në përputhje me Ligjin për Shoqatat dhe Fondacionet. Ky mjet synon më tej të lehtësojë dhe të inkurajojë pjesëmarrjen e qytetarëve në hartimin e politikave, duke u mundësuar organizatave të regjistruara të shoqërisë civile të marrin njoftime të rregullta në lidhje me punën e Kuvendit dhe organeve të tij të punës që janë me interes për to. Edhe pse kjo iniciativë përfaqëson një hap në drejtimin e duhur, zbatimi i saj nuk është plotësisht i dukshëm.

4.2. Agjendë parlamentare e parashikueshme dhe llogaridhënëse

Parlamenti vazhdon praktikën e përditësimit të rregullt të faqes së tij të internetit, e cila ka një mjet kërkimi funksional dhe ofron qasje në informacion mbi strukturën e shërbimit parlamentar (përmes organogramit), kompetencat dhe përbërjen e Parlamentit, tekstin e plotë të Kushtetutës dhe Rregullores së Punës, biografinë e kryetarit, përbërjen dhe kompetencat e secilit komision, si dhe kontaktet dhe biografitë për secilin deputet, duke përfshirë edhe emrat dhe pozicionet e nëpunësve të administratës publike.

Një nga rekomandimet nga shqyrtimi i vitit të kaluar ishte që Kuvendi të publikonte një listë të strukturuar të të gjithë deputetëve me të dhënat e tyre të kontaktit në format të hapur. Një grup i tillë të dhënash, i titulluar "Deputetët 2020 – 2024", edhe vitin e kaluar u publikua në Portalin e të Dhënave të Hapura vitin e kaluar, por ai nuk mund as të shihej e as të shkarkohej. Këtë vit, të

²¹ Gjetet në: <https://www.sobranie.mk/ns-newsarticle-registar-na-organizacii.nspix>

dhënat janë plotësisht funksionale dhe përmbajnë informacione për: emrin dhe mbiemrin e deputetit, fotografinë, partinë, njësinë zgjedhore, datën e lindjes dhe gjininë, përkatësinë etnike, vendin e lindjes dhe vendbanimin, nivelin e arsimit dhe profesionin, aktivitetet në Kuvend, anëtarësimet jashtë organeve të punës, e-mail-in për kontakt dhe përbërjen parlamentare.

Megjithëse e mirëpresim publikimin e kësaj pasqyre, duhet të theksojmë se ky është grup të dhënash për deputetët e përbërjes parlamentare 2020-2024 dhe ai duhet të publikohet edhe për përbërjen e re parlamentare me mandat 2024-2028, gjegjësisht për deputetët aktualë. Informacioni i vjetëruar dhe ai që nuk publikohet në kohën e duhur e pengon pjesëmarrjen e informuar dhe në kohë të qytetarëve.

Atë që Kuvendi nuk e merr parasysh si rekomandim për të nëntin vit radhazi është publikimi i rrogave të deputetëve dhe udhëheqjes parlamentare, si dhe informacionin në lidhje me mjetet që ata i kanë kërkuar në formën e shpenzimeve të udhëtimit.

Edhe pse Kuvendi publikon rregullisht raporte vjetore gjithëpërfshirëse²² për punën e tij, punën e trupave punuese dhe shërbimeve parlamentare, si dhe punën e Kryetarit të Kuvendit²³, tashmë **për të tetin vit radhazi, nuk ka publikuar program vjetor të punës mbi të cilin të bazonte aktivitetet e tij, zbatimin e strategjive përkatëse dhe raportet pasuese vjetore.**

Publikimi i programit vjetor të punës, si dhe i kalendarit paraparak të aktiviteteve, është me rëndësi thelbësore për përmirësimin e parashikueshmërisë dhe efikasitetit të punës së Kuvendit. Një qasje e tillë do të kontribuonte për një debat me cilësi më të lartë, i cili mbetet ende në një nivel relativisht të ulët, për koordinim më të mirë midis partive politike, rritje të transparencës dhe llogaridhënies ndaj publikut.

Në këtë drejtim, në vitin 2023 Kuvendi filloi aktivitetet për të krijuar kalendarin parlamentar²⁴, duke i hartëzuar rregullat, praktikat dhe proceset ekzistuese, me qëllim të krijimit të një kornize kohore më të parashikueshëm për punën. Sipas modelit të zgjedhur, seancat e trupave punuese janë planifikuar të mbahen çdo të hënë dhe të martë, ndërsa seancat plenare çdo të mërkurë dhe të enjte.

4.3. Besimi institucional përmes transparencës strategjike

Parlamenti vazhdoi ta avancojë transparencën e tij si pjesë e Partneritetit për Qeverisje të Hapur (PQH) përmes zbatimit të dy planeve kombëtare të veprimit: Plani Kombëtar i Veprimit (PKV) 2021 – 2023; dhe Plani Kombëtar i Veprimit (PKV) 2024 – 2026.

Në kuadër të Planit Kombëtar të Veprimit (PKV) 2021-2023, u zbatuan aktivitete të tilla si modernizimi i faqes së internetit, hapja e Portalit të të Dhënave të Hapura dhe prokurimi i

²² Gjendet në: <https://www.sobranie.mk/godishen-izveshtaj.nspix>

²³ Gjendet në: <https://www.sobranie.mk/izveshtaj-za-rabotata-na-pretседателот-na-sobranieto.nspix>

²⁴ Gjendet në: <https://www.sobranie.mk/kalendar.nspix>

pajisjeve për transmetim të drejtpërdrejtë të seancave, për të cilat tashmë po vërehen rezultate të dukshme.

Në vitin 2023, Parlamenti hartoi gjithashtu Planin Kombëtar të Veprimit (PKV) për periudhën 2024-2026.²⁵, i cili parashikon krijimin e një regjistri të organeve rregullatore të krijuara nga Parlamenti, informimin e publikut përmes kanalit televiziv të Parlamentit, zhvillimin e një debati mbikëqyrës mbi zbatimin e PKV-së 2024 - 2026, si dhe organizimin e një karvani parlamentar - një parlamenti mobil për komunikim të drejtpërdrejtë midis deputetëve dhe qytetarëve.

Në portalin zyrtar të Partneritetit për Qeverisje të Hapur, të katër angazhimet kanë statusin "nuk kanë filluar".²⁶ Nuk ka raporte mbi aktivitete konkrete ose statistika se si përdoret kanali i Kuvendit²⁷, por qasja në faqen e internetit jep besimin se ai shërben vërtet për të informuar hollësisht publikun. Ka informacione për dy emisione me natyrë substanciale rreth transparencës së Kuvendit. "Brifiingu legjislativ" është një emision informues ku prezantohen arsyet për miratimin e ligjeve të propozuara, si dhe qëllimet, parimet dhe zgjidhjet e tyre, si dhe zgjidhjet përfundimtare të ligjeve të miratuara. Ky emision e informon publikun rreth ligjeve të propozuara dhe të miratuara, siç janë formuluar nga propozuesit, deputetët ose Qeveria. "Intervista" është një emision informativ në të cilin zhvillohen intervista me Kryetarin dhe nënkryetarët e Kuvendit, koordinatorët e grupeve parlamentare në Kuvend, Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit dhe zëvendësit e tij; pastaj me udhëheqësit kryesorë në shtet, Presidentin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Kryeministrin e Republikës së Maqedonisë së Veriut; me ish-kryetarët e Kuvendit; me persona udhëheqës, puna dhe kompetenca e të cilëve lidhet me aktivitetet e projekteve në Kuvend, si dhe me drejtuesit e organizatave që marrin pjesë në procesin legjislativ si palë të interesuara; organet rregullatore; institucionet e pavarura nga të gjitha fushat e të ngjashme. Përveç kësaj, transmetohen programe edukative, duke përfshirë programe edukative, dokumentare dhe historike si rezultat i bashkëpunimit me Institutin Parlamentar në Kuvend dhe donatorët (Programi i Mbështetjes Parlamentare), dhe bashkëpunimit me kanale të tjera parlamentare, si dhe transmetime të ngjarjeve në Parlamentin Evropian, Kombet e Bashkuara dhe organizata të tjera ndërkombëtare.

Rekomandohet që Parlamenti t'i zbatojë në kohë dhe plotësisht angazhimet nga Plan i Veprimit dhe të zgjerojë numrin e organizatave të shoqërisë civile të përfshira në zbatimin e tyre. Rekomandohet që Parlamenti të marrë pjesë aktive në përditësimin e aktiviteteve të Portalit për të Dhënat e Hapura me qëllim të informimit në kohë të publikut rreth progresit dhe rezultateve të zbatimit të angazhimeve.

²⁵ Plan i Kombëtar i Veprimit për PQH (2024- 2026). Partneriteti për Qeverisje të Hapur, Maqedonia e Veriut:

Gjendet në: <https://tinyurl.com/5fymkda7>

²⁶ Gjendet në: <https://ovp.gov.mk/%d1%81%d0%bb%d0%b5%d0%b4%d0%b5%d1%9a%d0%b5-%d0%bd%d0%b0-%d0%bd%d0%b0%d0%bf/>

²⁷ Gjendet në: <https://www.sobranie.mk/sobraniski-kanal-tv-studio.nspx?utm>

Kuvendi është i orientuar strategjikisht drejt rritjes së hapjes së institucioneve jo vetëm përmes përfshirjes aktive në iniciativën e Partneritetit për Qeverisje të Hapur, por edhe përmes miratimit të Planit Strategjik për periudhën 2024-2028²⁸ dhe Planit Strategjik për periudhën 2025 – 2029.

Në qershor të vitit 2024, u mbajt një punëtori për të zhvilluar Planin Strategjik për periudhën 2025-2029²⁹, ku morën pjesë 35 zyrtarë të Kuvendit. Këshilli i Buxhetit i Kuvendit e miratoi planin në gusht të vitit 2024. Strategjia ka gjashtë qëllime, edhe atë: Kuvend funksional, Kuvend i hapur, Kuvend digjital, Kuvend i sigurt, diplomaci e Kuvendit dhe shërbim efikas.

Në të njëjtën kohë, parashikohet të zhvillohet një kulturë e transparencës dhe përfshirjes duke inkurajuar një publik të informuar, me vëmendje të veçantë ndaj kategorive të cënueshme të qytetarëve, si dhe komunikim proaktiv me mediat dhe rritje të disponueshmërisë së të dhënave. Për më tepër, transformimi digjital i parlamentit zë një vend të rëndësishëm në plan, ku digjitalizimi i shërbimeve është vendosur si prioritet. Për realizimin e secilit prej këtyre qëllimeve dhe prioritetëve, Plani Strategjik parashikon edhe vlera kyçe, drejt realizimit të të cilave synon procesi.

Megjithëse e njohim rolin e rëndësishëm të këtyre dokumenteve si bazë për udhëheqjen e punës, besojmë se që ato të kenë peshë dhe efekt të vërtetë, **është e nevojshme të ketë plane veprimi të qarta, vjetore**. Për secilin qëllim dhe prioritet strategjik, është e nevojshme të parashikohen aktivitete konkrete – jo vetëm në mënyrë deklarative, por me tregues të saktë të matshëm, si sasiore ashtu edhe cilësore. E gjithë kjo duhet të vendoset brenda një afati kohor të përcaktuar qartë dhe me një organ të përcaktuar saktësisht që do të jetë përgjegjës për zbatimin e tij. Që procesi të jetë vërtet i gjallë dhe të mund të ndiqet, **është e nevojshme të krijohet një kornizë për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e rregullt, dhe kështu të caktohet një subjekt kompetent që do ta udhëheqë dhe koordinojë këtë punë**. Vetëm në këtë mënyrë angazhimet strategjike do të mund të transformohen në rezultate të dukshme.

Në këtë drejtim, rekomandohet që Kuvendi të zhvillojë dhe të shpallë publikisht një strategji të veçantë për komunikim me publikun. Edhe pse Shërbimi i Kuvendit informoi se është përgatitur Strategjia për Komunikim me Publikun, ajo ende nuk është miratuar zyrtarisht dhe as nuk është publikuar në faqen e internetit të institucionit, gjë që thekson më tej nevojën për veprime urgjente në këtë drejtim. Është e rëndësishme të theksohet se vitin e kaluar morëm një përgjigje të ngjashme nga Kuvendi për këtë çështje, gjë që çon në përfundimin se strategjia nuk mund të miratohet zyrtarisht për dy vjet me radhë.

Analizat e perceptimeve të qytetarëve tregojnë qartë nevojën për një qasje të tillë - sipas të dhënave nga viti 2024, qytetarët e vlerësuan punën e Kuvendit me një vlerësim mesatar prej 2,3, me ç'rast shënon një rritje pothuajse të papërfillshme prej 0,1 pikësh krahasuar me vlerësimin

²⁸ Plani Strategjik i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2024 – 2028. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjetet në: <https://tinyurl.com/5d8chf7r>

²⁹ Plani Strategjik i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2025 – 2029. Gjetet në: [Plani Strategjik 2025-2029.pdf](#)

që qytetarët e dhanë në vitin 2023, gjegjësisht 2,2³⁰. Shumica e kritikave të shprehura nga qytetarët lidhen me kryerjen jo konsistente të funksionit mbikëqyrës dhe ndjenjën në rritje të korrupsionit. Domethënë, në hulumtim thuhet se "Perceptimi i shumicës së qytetarëve është se Kuvendi nuk e shfrytëzon plotësisht kompetencën e tij kushtetuese për të kontrolluar Qeverinë, gjegjësisht një e katërta (23%) e të anketuarve konsiderojnë se Qeveria ka kontroll të plotë mbi Kuvendin".

Kuvendi ka gjithashtu Strategji për Menaxhimin e Rreziqeve me kohëzgjatje nga viti 2023 deri në vitin 2028 dhe gjithashtu ka qëllime specifike. Qëllimet kanë për qëllim përmirësimin e efikasitetit në menaxhimin e rreziqeve dhe realizimin e papenguar të qëllimeve strategjike dhe operative të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Duke u përballur në mënyrë proaktive me kërcënimet dhe duke i shfrytëzuar mundësitë, ajo përpiket për integrimin e plotë të menaxhimit të rreziqeve në kulturën administrative të institucionit. Qasja përfshin vendosjen e komunikimit adekuat dhe përfshirjen e menaxhimit të rreziqeve si standard në procesin e vendimmarrjes. Për më tepër, synon të minimizojë pasojat (kostot), të krijojë një kornizë për identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve, si dhe të jetë në përputhje me Ligjin për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik. Ky dokument përfaqëson një qasje sistemore ndaj menaxhimit të rreziqeve në punën e Kuvendit dhe përfshin një regjistër të rreziqeve për të gjitha 18 njësitë organizative, të harmonizuara me procedurat e përcaktuara ISO brenda kornizës së politikës së cilësisë. Kuvendi e posedon standardin ISO 9001, dhe nga viti 2023, edhe standardin ISO 27001.

4.4. Përfshirja e publikut në punën e organeve parlamentare

Në përgjithësi, Kuvendi demonstroi përkushtimin e tij ndaj transparencës duke publikuar rregullisht raporte vjetore të detajuara mbi punën, strategjitë e tij, si dhe raportet vjetore nga komisionet, si pjesë e raportit të përgjithshëm të Kuvendit. Për më tepër, rendet e ditës dhe dokumentet për seancat plenare të ardhshme, amendamentet e propozuara dhe të miratuara, si dhe informacioni mbi pjesëmarrjen e deputetëve në seancat plenare, publikohen në kohën e duhur.

Këtë vit, ka pasur një përmirësim në publikimin e informacionit mbi prezencën e deputetëve në seancat e trupave punuese. Publikimi "Deputeti im", që botohet rregullisht nga Kuvendi, përmban detaje rreth pjesëmarrjes dhe mungesave në seancat plenare dhe të komisioneve, pjesëmarrjes në diskutime, si dhe për numrin e ligjeve dhe amendamenteve të propozuara. Gjithashtu, analizohet puna e trupave punues të Kuvendit, numri i ligjeve të miratuara sipas fushave, si dhe të dhënat mbi seancat plenare dhe seancat e komisioneve.³¹

Megjithatë, disa komisione mbajnë procesverbale të rregullta dhe të përpikta, ndërsa të tjerat nuk e bëjnë këtë ose e bëjnë herë pas here. Kuvendi i publikon rregullisht dhe në kohë shënimet

³⁰ Gjendet në: [Pasqyrë e Kuvendit: Perceptimet e qytetarëve për punën të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut \(2024 IDSCS\)](#)

³¹ Publikimi "Deputeti im". Gjendet në:

<https://www.sobranie.mk/content/%D0%9C%D0%BE%D1%98%D0%BE%D1%82%20%D0%BF%D1%80%D0%B0%D1%82%D0%B5%D0%BD%D0%B8%D0%BA/mp31mk-2.pdf>

e stenogrameve të seancave plenare, por ende nuk publikon shënime të stenogrameve të seancave të trupave punues. Ueb-faqja përmban dokumente që janë në rend të ditës ose që rrjedhin nga puna e komisioneve.³², por edhe këtu ka mungesë konsistence në praktikën midis komisioneve të ndryshme.

Kuvendi mbetet konsekuent ndaj praktikës së mirë të ndjekjes së lehtë të votimit në seancat plenare, ku për secilën pikë tregohet qartë se cilët deputetë ka qenë të pranishëm dhe si kanë votuar. Megjithatë, ende mungon publikimi sistematik i mënyrës së votimit të deputetëve gjatë seancave të komisioneve, gjë që do të kontribuonte për transparencë shtesë.³³

Pas lidhjes së sallave të komisioneve dhe sallës plenare me pajisje audio dhe video, server mediatik dhe faqen e internetit të Kuvendit, gjë që ndodhi në vitin 2023, u bë e mundur ndjekja e seancave përmes internetit dhe pjesërisht edhe përmes mediave sociale. Seancat plenare mund të ndiqen drejtpërdrejt në faqen e internetit të Kuvendit dhe nëpërmjet kanalit televiziv të Kuvendit. Një përmirësim i rëndësishëm është se videot e transmetimeve tani janë të disponueshme për çdo seancë plenare, gjë që nuk ishte rasti më parë.

Megjithatë, kur bëhet fjalë për transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave të trupave punues, ai ofrohet përmes kanalit parlamentar vetëm gjatë procedurës së miratimit të buxhetit. Për të gjitha seancat e tjera të trupave punues, regjistrimet audio dhe video publikohen përmes kanalit të Kuvendit dhe janë gjithashtu të disponueshme në faqen e internetit të Kuvendit. Duke pasur parasysh se tashmë janë siguruar kushtet teknike, **rekomandohet të bëhen transmetime të rregullta të drejtpërdrejta të të gjitha seancave të trupave punuese, me qëllim të përmirësimit të transparencës dhe llogaridhënies së Kuvendit.**

4.5. Llogaridhënia financiare në praktikë

Gjatë gjithë vitit 2024, Kuvendi mbeti i përkushtuar për forcimin e transparencës fiskale, me theks të veçantë në furnizimet publike. Kjo është e dukshme përmes praktikës së vazhdueshme të publikimit të planeve vjetore të furnizimeve publike³⁴, thirrjeve, vendimeve për përzgjedhje në formën e njoftimeve, si dhe kontratave së bashku me shtojcat (anekset). Edhe pse Parlamenti publikon një listë të detajuar të kontratave të realizuara të furnizimeve publike³⁵, **rekomandohet të publikohen raporte të shkurtra vjetore që do të përmbajnë informacion të përmbledhur mbi furnizimet e zbatuara dhe të pazbatuara, statusin e ekzekutimit dhe pagesës së kontratës, si dhe arsyet e ndërprerjes së kontratës.**

Për të përmirësuar transparencën e furnizimeve publike në të gjitha institucionet kombëtare dhe lokale, si dhe për të zvogëluar rrezikun e korrupsionit, është e nevojshme të përmirësohet korniza

³² Shembull nga një seancë e përfunduar e një komisioni parlamentar: <https://www.sobranie.mk/detali-na-komisiska-sednica.nsp?sessionId=a4dbac8a-a043-42bd-9fef-1c83c61a629d>

³³ Shembull i informacionit të pabotuar në lidhje me votimin e deputetëve në një seancë të mbyllur të një komisioni parlamentar: <https://www.sobranie.mk/detali-na-komisiska-sednica.nsp?sessionId=2c0ee919-a5a7-495f-86e4-824c96375065>

³⁴ Gjendet në: <https://www.sobranie.mk/godishen-plan-za-javni-nabavki-na-sobranieto.nsp>

³⁵ Gjendet në: <https://www.sobranie.mk/javni-nabavki.nsp>

ligjore. Në dhjetor të vitit 2024, në procedurë parlamentare hyri propozimi për të përmirësuar Ligjin për Furnizime Publike³⁶, i cili u miratua në janar të vitit 2025. Qëllimi themelor i propozim-ligjit për plotësimin e ligjit është të sigurojë masa për të forcuar kapacitetin dhe pavarësinë e Komisionit Shtetëror për Ankesa në Lidhje me Furnizimet Publike dhe për të përmirësuar kontrollin administrativ, i cili do të jetë një kontroll administrativ. Këto plotësime janë në përputhje me obligimet e Maqedonisë së Veriut sipas Agjendës së Reformave në kuadër të Planit të Rritjes për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Mirëpo, **propozimi ynë, për të cilin apelojmë edhe këtë vit, është përmirësimi i Ligjit për Furnizime Publike duke u kërkuar ofertuesve të njoftojnë publikisht pronësinë e personit juridik për të cilin po ofertojnë, me qëllim të parandalimit të dhënies së tenderëve kompanive në pronësi të individëve ose të afërmeve të ngushtë të funksionarëve publikë.** Kjo lidhet drejtpërdrejt me angazhimin 1.2 të planit aktual të veprimit PQH 2024-2026, gjegjësisht zbulimin publik të emrave të pronarëve të vërtetë të kompanive ofertuese dhe të kompanive që kanë lidhur kontrata për furnizime publike, për koncesione (në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë) dhe për krijimin e partneriteteve publiko-private.³⁷

Përveç kësaj, Ligji për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave³⁸ duhet të plotësohet me detyrimin për personat përgjegjës për zbatimin e furnizimeve publike, përveç funksionarëve, të dorëzojnë fleta anketuese, me qëllim që të shmanget nënshtrimi i tyre ndaj ryshfetit dhe aktiviteteve korruptive.

Këtë vit, Parlamenti vazhdoi praktikën pozitive të publikimit të rregullt në faqen e tij të internetit të buxhetit parlamentar, raporteve financiare mujore mbi ekzekutimin e buxhetit, si dhe të llogarisë përfundimtare që rezulton prej tij. Në mënyrë që publiku të ketë një pasqyrë të qartë të fondeve dhe qëllimit të tyre në punën e Kuvendit, **mbetet rekomandimi të publikohet Buxheti i qytetarëve në faqen e internetit.** Gjithashtu, **rekomandohet që të publikohen edhe raportet afatmesme mbi shpenzimet e buxhetit të shtetit.** Gjatë shqyrtimit të llogarive përfundimtare, pjesë përbërëse është edhe raporti i revizionit, ndërsa dokumentacioni nga organet parlamentare që e shqyrtojnë ose e miratojnë kornizën buxhetore dhe aktivitetet e financimit publik është i disponueshëm publikisht në faqen e internetit të Parlamentit.

Si një mangësi, e cila përsëritet prej disa vitesh, theksojmë se, ndonëse Komisioni për Financim dhe Buxhet ka diskutuar propozimin e fundit të buxhetit të shtetit, të gjitha komisionet e tjera duhet ta shqyrtojnë buxhetin brenda mandatit të tyre. Përveç kësaj, **mbetet rekomandimi që Kuvendi formalisht ta obligojë pushtetin ekzekutiv ta përfshijë publikun në procesin e krijimit të buxhetit, në mënyrë që buxheti të jetë në përputhje me nevojat e qytetarëve.**

³⁶ Gjendet në: <https://www.sobranie.mk/detali-na-materijal.nspx?param=3c1ef316-dfa9-4db7-8b5f-b6178ee36940>

³⁷ Gjendet në: <https://shorturl.at/Wjp0U>

³⁸ Gjendet në: <https://shorturl.at/ej81T>

4.6. Zhvillimi i praktikave për qasje të lirë në informata

Republika e Maqedonisë së Veriut ka një nga ligjet më të përparuara për qasje të lirë në informatat me karakter publik në rajon, por vazhdon të përballet me sfida në zbatimin e tij konsekuent. Mungesa e përpjekjeve rajonale për të avancuar transparencën kontribuon që legjislacioni i Maqedonisë të ruajë pozicionin e tij përpara vendeve të tjera në rajon. Megjithatë, respektim i detyrimeve ligjore nuk është integruar ende në mënyrë të përhershme në kulturën e punës së administratës publike.

Në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe rajonale, rekomandohet përmirësimi i mëtejshëm i kornizës ligjore, veçanërisht duke shkurtuar afatin për t'iu përgjigjur kërkesave për qasje në informata nga 20 në 15 ditë pune. Ky ndryshim do të kontribuonte në një afat kohor dhe efikasitet më të madh, si dhe do të parandalonte që informacioni i kërkuar të bëhej i vjetëruar.

Parlamenti demonstroi një qëndrim pozitiv ndaj transparencës duke paraqitur një përgjigje ndaj kërkesës sonë për qasje të lirë në informata me karakter publik brenda afatit ligjor, si dhe duke plotësuar pyetësin për hapjen institucionale, që është pjesë integrale e analizës sonë.

Për më tepër, në faqen zyrtare të internetit të Kuvendit ekziston një seksion i veçantë i dedikuar të drejtës për qasje të lirë në informatat me karakter publik. Ajo përmban të dhënat e kontaktit për zyrtarët përgjegjës për këtë fushë, tekstin e plotë të Ligjit me udhëzime për zbatimin e tij, formularët përkatës, raportet vjetore mbi zbatimin e Ligjit, si dhe link deri te Agjencia për Mbrotjtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik.

Në vitet 2023 dhe 2024, përfaqësuesit e Shërbimit Parlamentar morën pjesë në trajnimin për qasje të lirë në informatat me karakter publik me qëllim ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve të tyre dhe monitorimin e trendeve të reja në këtë fushë. Kuvendi përdori një zgjidhje të brendshme softuerike "e-trajtime" ku mbahet një dosje personale me të gjitha trajnimet gjenerike dhe të specializuara për secilin punonjës, gjë që ne besojmë se është një mënyrë e shkëlqyer për të monitoruar ngritjen e kapaciteteve të brendshme dhe për të vlerësuar nevojat e mëtejshme për përmirësim.

Me qëllim të përmirësimit të qasjes në informata dhe uljen e barrës administrative për shërbimin parlamentar, **rekomandohet që kërkesat e miratuara për qasje të lirë në informatat me karakter publik të publikohen rregullisht në faqen e internetit të Kuvendit.** Kjo praktikë do të kontribuonte në uljen e numrit të kërkesave individuale drejtuar institucionit, gjë që, nga ana tjetër, do t'u mundësonte shërbimeve parlamentare të përqendroheshin në aktivitete të tjera prioritare dhe thelbësore.

4.7. Afrimi i përfaqësuesve të popullit me qytetarët


Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut është një nga të paktat kuvende në rajon që ka hapur Zyra për kontakt me qytetarët në nivel lokal. Ligji për Kuvendin e rregullon funksionimin e zyrave për kontakte midis deputetëve dhe qytetarëve në çdo njësi zgjedhore. Këto zyra synojnë t'u mundësojnë qytetarëve të komunikojnë drejtpërdrejt me përfaqësuesit e tyre, të shkëmbejnë informacione, të japin propozime dhe sugjerime për çështje të caktuara, si dhe t'i shprehin më lehtë problemet me qëllim që të gjejnë zgjidhje të përbashkëta.

Gjatë muajve shtator-dhjetor 2024, Njësia për Mbështetjen e Zyrave për Kontakt të Deputetëve me Qytetarët në njësitë zgjedhore ka hapur gjithsej 39 zyra³⁹ në komunat e mëposhtme: Aerodrom, Haračinë, Manastir, Ilinden, Berovë, Veles, Vinicë, Resnjë, Vallandovë, Gostivar, Gjevgjeli, Gazi Babë, Karposh, Krushevë, Kratovë, Koçan, Kisella Vodë, Kavadar, Negotinë, Ohër, Petrovec, Probishtip, Strumicë, Shtip, Radovish, Mavrovë dhe Rostushë, Çair, Makedonski Brod dhe Novo Sellë. Këto zyra përfaqësojnë një kanal të rëndësishëm për qytetarët që të shprehin nevojat, sugjerimet dhe shqetësimet e tyre drejtpërdrejt te përfaqësuesit e tyre të zgjedhur, si dhe të marrin informacion në kohë rreth proceseve në Kuvend dhe nismave aktuale legjislative.

Megjithatë, jo të gjitha Zyrat për kontakt me qytetarët janë hapur, gjegjësisht nga 75 zyra të parashikuara nga projekti i Kuvendit i vitit 2003, 51 zyra janë hapur në vitin 2023⁴⁰. Në vitin 2024, ky numër u zvogëlua për 12, që do të thotë se të hapura ishin vetëm 39 zyra në periudhën shtator - dhjetor 2024, gjegjësisht pas krijimit të përbërjes së re parlamentare. Raporti për periudhën janar - maj 2024 nuk përmend hapjen e zyrave për kontakt me qytetarët. Kjo është një rënie e mëtejshme nga numri i zyrave të hapura në vitin 2022, i cili ishte 52. Zvogëlimi i zyrave do të thotë që qytetarët nuk kanë qasje dhe kontakt të barabartë me përfaqësuesit e tyre të zgjedhur në Kuvend.

³⁹ Raporti për punë i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 25.8.2024 - 31.12.2024. Qasur më 24.7.2025. Gjetet në: <https://www.sobranie.mk/godishen-izveshtaj.nspix>

⁴⁰ Raporti për punë i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjetet në: <https://www.sobranie.mk/content/izvestai/GODISEN%20IZVESTAJ%202023.pdf>



Infografiku 7. Përqindja e Zyrave të hapura për kontakt me qytetarët

Ka një rënie të dukshme të informacionit në lidhje me Zyrat për kontakt me qytetarët. Vitin e kaluar, raportuam se, me përmirësimin e faqes së internetit, Kuvendi e përmirësoi edhe hartën e zyrave dhe për 34 zyra ofron informacion mbi orarin e punës dhe adresën e zyrës, personin e kontaktit së bashku me numrin e tyre të telefonit, si dhe deputetët që punojnë në atë zyrë dhe partinë politike që e përfaqësojnë. Këtë vit numri i zyrave për të cilat ka informacion është 8⁴¹. Disa prej tyre kanë link të zbrazët, që do të thotë se kur klikohen, nuk çojnë në ndonjë informacion praktik ose të dobishëm.

Gjatë periudhës shtator-dhjetor 2024, zyrat për takime me qytetarët regjistruan 1.146 vizita, gjë që tregon për një interes të lartë për komunikim të drejtpërdrejtë me deputetët dhe për përdorimin e këtyre hapësirave si platforma për shprehjen e pikëpamjeve dhe nevojave. U regjistruan gjithsej 806 raste të reja, pavarësisht nëse ato u zgjidhën apo ishin ende në proces, të cilat përfshinin një sërë kërkesash dhe propozimesh të parashtruara nga qytetarët dhe të dërguara më tej te institucionet kompetente. Janë zgjidhur 259 raste, gjë që është provë e efikasitetit të zyrave dhe përkushtimit të deputetëve dhe ekipeve të tyre për t'u përgjigjur ndaj sfidave qytetare. Për më tepër, duke u bazuar në nevojat e shprehura nga qytetarët, Kuvendit iu parashtruan 239 pyetje parlamentare me qëllim nxitjen e debatit publik dhe veprimtari institucionale. Gjatë së njëjtës periudhë, u ngritën edhe 105 iniciativa qytetare, të cilat rrjedhin nga probleme dhe propozime konkrete të parashtruara nëpërmjet zyrave, gjë që e thekson më tej rolin e tyre në avancimin e proceseve demokratike dhe përfshirjes politike⁴².

Këtë vit, Parlamenti vazhdoi përpjekjet e tij për të edukuar qytetarët dhe për të rritur ndërgjegjësimin publik përmes organizimit të punëtorive edukative, seminareve dhe vizitave në Parlament, si dhe përmes përdorimit aktiv të profileve në rrjetet sociale për të informuar rreth aktiviteteve të tij. Megjithatë, kur bëhet fjalë për përfshirjen kuptimplote të publikut në procesin

⁴¹ Gjendet në: <https://www.sobranie.mk/kancelarii-za-kontakt-so-gragjanite1.nspj>

⁴² Gjendet në: <https://www.sobranie.mk/content/izvestai/izveshtajsobranie%2025.8.2025-31.12.2025.pdf>

legjislativ, gjetjet mbeten dekurajuese. Edhe pse sektori i shoqërisë civile dhe ekspertët e pavarur kanë të drejtën formale për të marrë pjesë ose për të monitoruar punën e organeve parlamentare, gjatë vitit 2024, komisionet kërkuar mendim nga publiku në më pak se dhjetë raste në lidhje me ligjet, strategjitë, deklaratat ose iniciativat e tjera.

Është e rëndësishme të theksohet se **edhe pse kemi bërë apel për të gjashtin vit radhazi, Kuvendi ende nuk ka krijuar një praktikë të publikimit të opinionëve të ekspertëve nga Komisioni Evropian, Komisioni i Venedikut, TAIEK-i dhe organet e tjera relevante së bashku me propozim-ligjet. Për më tepër, rekomandohet që të publikohen edhe mendimet e ekspertëve të shprehura në kuadër të konsultimeve.**

Gjithashtu, **Për të gjashtin vit radhazi, theksojmë domosdoshmërinë e futjes së një mekanizmi për peticione elektronike**, i cili nuk është ende e disponueshëm. Njëfarë progresi drejt krijimit të një mjedisi demokratik online paraqet lëshimi në përdorim i Regjistrat të Organizatave⁴³, i cili ka potencialin të kontribuojë në pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e hartimit të politikave. Megjithatë, zbatimi i tij mbetet për t'u monitoruar.

Për të përmirësuar komunikimin midis qytetarëve dhe Parlamentit, rekomandohet të krijohet një kanal komunikimi i drejtpërdrejtë përmes faqes së internetit të institucionit, i shoqëruar me udhëzime të qarta për parashtrimin e vërejtjeve dhe apeli meve.

Një praktikë e mirë do të ishte futja e një afati të shpallur publikisht brenda të cilit qytetari do të merrte përgjigje, si dhe një sistem për monitorimin në kohë reale të procesit të trajtimit të ankesave të parashtruara. Vetëm nëpërmjet një mekanizmi të tillë funksional qytetarët mund të kenë ndjenjën se janë të dëgjuar, gjë që është një hap kyç drejt rikthimit të besimit të tyre ndaj Parlamentit.

4.8. Demokracia funksionale përmes kontrollit të forcuar mbi pushtetin ekzekutiv

Në raportin e tij të fundit të progresit për vendin, Komisioni Evropian thekson se efektiviteti i mbikëqyrjes parlamentare mbi financat publike, si dhe monitorimi i zbatimit të rekomandimeve nga raportet e revizionit, mbeten fusha në të cilat nevojiten përmirësime të konsiderueshme. Raporti vë në dukje se roli mbikëqyrës i Kuvendit mbi pushtetin ekzekutiv ushtrohet, ndër të tjera, nëpërmjet mbajtjes së seancave mujore për pyetje parlamentare.

Për të avancuar këtë funksion, Parlamenti ndërmori një hap pozitiv duke përfshirë strategjikisht aktivitetin "Debat mbikëqyrës në Parlament mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2024-2026" në Planin Kombëtar të Veprimit për periudhën e specifikuar.

⁴³ Regjistri i Organizatave. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjetet në: <https://registar.sobranie.mk/>

Megjithatë, sipas të dhënave në dispozicion, nga viti 2021 deri më sot, është mbajtur vetëm një debat mbikëqyrës – në vitin 2023, kushtuar zbatimit të dispozitave ligjore të Ligjit për Personat e Paevidentuar në Librin Amë të të Lindurve⁴⁴. Për të siguruar zbatimin e qëndrueshëm të rolit mbikëqyrës, rekomandohet të vendosen sanksione për ministrat dhe funksionarët e tjerë ekzekutivë që mungojnë pa të drejtë në debatet mbikëqyrëse. I njëjti raport thotë se në vitin 2024, Parlamenti mbajti tre debate publike dhe zgjodhi dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, një Prokuror Publik, anëtarë të Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, si dhe anëtarë të Agjencisë për Komunikime Elektronike.

Me qëllim të nxitjes së bashkëpunimit në ushtrimin e kompetencave brenda fushëveprimit të Kuvendit dhe Entit Shtetëror të Revizionit, nëpërmjet marrëdhënieve profesionalisht të qëndrueshme dhe efikase që synojnë forcimin e efikasitetit dhe transparencës së mbikëqyrjes financiare publike, Kuvendi nënshkroi një Memorandum Bashkëpunimi me Entin Shtetëror të Revizionit⁴⁵. Memorandumi e rregullon mënyrën e komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit midis Entit Shtetëror të Revizionit dhe Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me qëllim të avancimit të rolit mbikëqyrës të Kuvendit. Në vitin 2024, Parlamenti e shqyrtoi Raportin vjetor mbi revizionet e kryera dhe për punën e Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2023, i cili përmban një pasqyrë të përmbledhur dhe gjetjet e të gjitha revizioneve të kryera gjatë vitit.

4.9. Përkushtimi sistematik ndaj integritetit në organin legjislativ

Kodi i Sjelljes Etike⁴⁶ të deputetëve i cakton procedurat për trajtimin e rasteve të shkeljeve të dispozitave të tij, duke përfshirë edhe detyrimin për të shpallur publikisht rezultatet përfundimtare të hetimeve që lidhen me pretendimet për sjellje joetike. Gjatë vitit 2024, nuk u regjistrua asnjë procedurë për përcaktimin e shkeljeve të Kodit. **Për të gjashtin vit radhazi, është vënë në dukje mungesa e mekanizmave efektivë për monitorimin e zbatimit të tij. Për më tepër, mbetet aktual edhe rekomandimi për të forcuar rregulloret në lidhje me aktivitetet politike dhe raportimin e gjendjes pronësore të deputetëve përmes vetë Kodit.**

Fletët anketuese të pasurisë për të gjithë deputetët dhe funksionarët janë të disponueshme publikisht në format elektronik në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit. Megjithatë, **rekomandohet që këto të dhëna të integrohen si hiperlink ose si skeda të veçanta brenda biografive të deputetëve dhe funksionarëve në faqen e internetit të Kuvendit, në mënyrë që të ofrohen skedarë të plotë dhe funksionalë.**

⁴⁴ Debat mbikëqyrës mbi temën: "Zbatimi i dispozitave ligjore të Ligjit për Personat e Paevidentuar në Librin amë të të Lindurve". Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjendet në: <https://tinyurl.com/yvufauvy>

⁴⁵ Memorandum Bashkëpunimi midis Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Entit Shtetëror të Revizionit. Enti Shtetëror për Revizion. Gjendet në: https://dzt.mk/sites/default/files/2022-10/Memorandum_Sobranie_RSM_DZR.pdf; https://dzt.mk/sites/default/files/2022-10/Memorandum_Sobranie_RSM_DZR.pdf

⁴⁶ Kodi. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjendet në: <https://www.sobranie.mk/kodeks.nspk>

Edhe gjatë këtij viti, Parlamenti vazhdoi me aktivitete për të ngritur kapacitetet e nëpunësve të tij në fusha të tilla si parandalimi i konfliktit të interesave, masat kundër korrupsionit dhe mbrojtja e sinjalizuesve. Me qëllim të forcimit të integritetit institucional, Kuvendi zbaton Strategjinë për Menaxhimin e Rreziqeve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2023-2028.⁴⁷, e cila parashikon krijimin e një regjistri të rreziqeve për të gjitha njësitë organizative, në përputhje me procedurat ISO brenda kuadrit të politikës së cilësisë. Për të rritur llogaridhënien ndaj publikut në lidhje me zbatimin e kësaj strategjie, rekomandohet që të publikohen rregullisht raporte vjetore mbi zbatimin e saj.

⁴⁷ Strategjia për Menaxhimin e Rreziqeve e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2023 – 2028. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjendet në: <https://tinyurl.com/3huy68yv>

UDHËRRËFYES PËR QEVERISJE TË MIRË PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



Udhërrëfyes për qeverisje të mirë për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Duke u bazuar në analizën e këtij viti, kemi përgatitur një sërë rekomandimesh që i adresojnë problemet e lartpërmendura dhe të cilat duhet të shërbejnë si një plan gjithëpërfshirës për qeverisje të mirë të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Transparenca

- Ueb-faqja e Kuvendit duhet të përshtatet për të qenë e qasshme nga të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara në përputhje me Udhëzimet për Qasshmërinë e Përmbajtjeve në Uebit (WCAG).
- Kuvendi duhet ta hartojë dhe ta publikojë rregullisht programin vjetor të punës, dhe duke u bazuar në të, të publikojë një kalendar paraprak për aktivitetet e tij.
- Rekomandohet që Kuvendi të prodhojë dhe të përditësojë më shumë të dhëna të hapura dhe të braktisë praktikën e publikimit të dokumenteve të skanuara ose të pakërkueshme për të siguruar qasje më të madhe në informata.
- Në faqen e internetit, Kuvendi duhet t'i publikojë rrogat e deputetëve dhe të udhëheqësisë së Kuvendit, si dhe mjetet që ata i kanë kërkuar në formën e shpenzimeve të udhëtimit.
- Plani strategjik i Kuvendit duhet të mbështetet me plane vjetore të veprimit, ku për secilin qëllim dhe prioritet, do të përcaktohen aktivitete specifike, për të cilat do të vendosen tregues sasiorë dhe cilësorë të suksesit të përcaktuar saktësisht, me një afat kohor të përcaktuar saktësisht për përmbushje dhe organin përgjegjës. Për një monitorim më të suksesshëm të arritjes së angazhimeve strategjike, rekomandohet të krijohet një kornizë për monitorim, vlerësim dhe raportim, si dhe të përcaktohet një organ që do të jetë përgjegjës për këtë.
- Kuvendi duhet të miratojë dhe publikojë një strategji të veçantë komunikimi (PR), sipas së cilës do të komunikojë me palë të ndryshme të interesuara përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit.
- Kuvendi duhet të publikojë video-incizimet e çdo seance të komisioneve në faqen e tij të internetit.
- Kuvendi duhet të sigurojë transparencë më të madhe të seancave të komisioneve, gjegjësisht për të gjitha seancat e komisioneve duhet të publikohen rregullisht të gjitha dokumentet që dalin nga seancat, duke përfshirë edhe shënimet stenografike, informacionin mbi prezencën e deputetëve në seanca dhe të dhënat e votimeve në to.
- Kuvendi duhet të publikojë mendimet e ekspertëve të shprehura si pjesë e konsultimeve dhe, së bashku me propozim-ligjet, të publikojë edhe mendimet e dhëna nga organet ndërkombëtare (për shembull, Komisioni i Venedikut).
- Kuvendi duhet të publikojë Buxhetin e qytetarëve nga buxheti i shtetit dhe të përgatisë dhe të publikojë në faqen e tij të internetit Buxhetin e qytetarëve nga buxheti i Kuvendit.
- Të gjitha komisionet në kuadër të Kuvendit duhet ta shqyrtojnë propozimin e buxhetit të shtetit brenda mandatit të tyre.

- Kuvendi duhet formalisht ta obligojë pushtetin ekzekutiv që ta përfshijë publikun në procesin e krijimit të buxhetit.
- Të ndryshohet dhe të plotësohet Ligji për Furnizimet Publike, i cili do t'i detyrojë ofertuesit të deklarojnë publikisht pronësinë e personit juridik në emër të të cilit ofertojnë, e gjitha kjo me qëllim që të shmanget dhënia e tenderëve kompanive në pronësi të individëve ose të afërmeve të ngushtë të individëve që mbajnë funksione publike.
- Ligji për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave duhet të plotësohet me detyrimin që, përveç funksionarëve, edhe personat përgjegjës për zbatimin e furnizimeve publike, detyrimisht të dorëzojnë fleta anketuese, me qëllim që të shmanget nënshtrimi i tyre ndaj ryshfetit dhe aktiviteteve korruptive.

Qasshmëria

- Në përputhje me praktikën ndërkombëtare, Ligji për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik duhet ta shkurtojë më tej afatin për t'u përgjigjur ndaj kërkesave nga 20 ditë në 15 ditë, me qëllim që të sigurohet efikasitet më i madh dhe të shmanget vjetërimi i informacionit që kërkohet.
- Kuvendi duhet ta publikojë rregullisht informacionin për të cilin tashmë është miratuar qasje e lirë. Kjo do ta zvogëlonte ndjeshëm numrin e kërkesave drejtuar Kuvendit, gjë që do t'u jepte atyre hapësirë shtesë për t'iu përkushtuar proceseve të tjera.
- Kuvendi duhet të miratojë një akt të brendshëm mbi proceset konsultative. Derisa të miratohet një akt i tillë, komisionet duhet të bashkëpunojnë dhe të kërkojnë më shpesh mendimin e publikut duke hapur thirrje publike për komente dhe sugjerime nga publiku.
- Kuvendi duhet të theksojë kufizimin e praktikës së miratimit të ligjeve përmes procedurës së shkurtuar dhe procedurës me "flamurin e BE-së" vetëm në kushtet e parapara, dhe të mos e keqpërdorë këtë mekanizëm.
- Kuvendi duhet të hapë një kanal komunikimi të drejtpërdrejtë në faqen e tij të internetit me udhëzime për parashtrimin e vërejtjeve dhe ankesave, si dhe të krijojë një mekanizëm të veçantë për peticionet elektronike.
- Kuvendi duhet t'i zbatojë në kohë dhe plotësisht angazhimet nga Plan i Veprimit i Partneritetit për Qeverisje të Hapur të Kuvendit, si dhe ta zgjerojë numrin e organizatave të shoqërisë civile të përfshira në zbatimin e angazhimeve dhe krijimin e Planit të ri të Veprimit.
- Kuvendi, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes lokale, Shoqatën e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale (BNJVL) dhe Qeverinë, duhet të rishikojë nevojën për të hapur 75 në vend të 81 zyrave për kontakt me qytetarët, me një qasje që do të mbulojë të gjitha komunat dhe Qytetin e Shkupit. Në të njëjtën kohë, ata duhet t'i hapin edhe zyrat e mbetura për të siguruar mundësinë që të gjithë qytetarët t'ua paraqesin nevojat e tyre deputetëve të tyre.
- Kuvendi duhet ta përmirësojë hartën e zyrave për të ofruar të dhëna mbi të gjitha zyrat e hapura për kontakt me qytetarët.

Integriteti

- Kodi i sjelljes etike të deputetëve duhet ta rregullojë edhe aktivitetin politik të deputetëve.
- Kuvendi duhet të krijojë mekanizma koncizë për monitorimin e zbatimit të Kodit të sjelljes etike të deputetëve.
- Kuvendi duhet të publikojë informacion për mbrojtjen e informatorëve në ueb-faqen e tij.
- Për një llogaridhënie më të madhe ndaj publikut për zbatimin e detyrimeve nga Strategjia e Menaxhimit të Rreziqeve, rekomandohet publikimi i raporteve vjetore.
- Rekomandojmë që fletët anketuese të pasurisë të vendosen si hiperlink ose si skedë brenda biografisë së secilit deputet ose funksionar, në mënyrë që dosjet e tyre të jenë të plota.

Efikasiteti

- Kuvendi duhet ta përfshijë më shpesh publikun në punën e tij përmes mekanizmave ekzistues për përfshirjen e sektorit të shoqërisë civile dhe ekspertëve të pavarur.
- Të gjitha vlerësimet e ndikimit rregullator, pavarësisht nga procedura legjislative, duhet t'i dorëzohen Kuvendit së bashku me aktet e propozuara. Në të njëjtën kohë, Kuvendi duhet të fillojë të praktikojë vlerësimin strategjik të ndikimeve të mundshme të akteve ligjore ekzistuese dhe të përgatitura, veçanërisht të atyre që vijnë si propozime nga vetë Kuvendi.
- Kuvendi duhet të ushtrojë më shpesh mbikëqyrje mbi pushtetin ekzekutiv përmes pyetjeve parlamentare drejtuar ministrave.
- Kuvendi duhet të vendosë sanksione për ministrat dhe funksionarët e tjerë ekzekutivë për mospjesëmarrje në debatet mbikëqyrëse.

Fondacioni për Internet dhe Shoqëri - Metamorfozis është fondacion i pavarur, jopartiak dhe jofitimprurës me seli në Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Misioni i tij është të kontribuojë për zhvillimin e demokracisë dhe për rritjen e cilësisë së jetës përmes shfrytëzimit inovativ dhe shpërndarjes së njohurive. Vlerat tona kryesore janë transparenca, barazia dhe liria.

Fushat programore në të cilat punon Fondacioni “Metamorfozis” janë:

- Transformimi digjital i përgjegjshëm
- Përgjegjësia shoqërore
- Integriteti i mediave dhe informacionit

Fondacioni për Internet dhe Shoqëri - “Metamorfozis”

Rr. "Franklin Ruzvelt" Nr. 19, Kati 2, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut

e-mail: info@metamorphosis.org.mk

tel: +389 2 3109 325

www.metamorphosis.org.mk

